



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0544

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Batisha Ibrahim - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE “BAJRAM HA.GASHI” B.I., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i objektit të NPL EKO - THERANDA ne Shirok” me numër të prokurimit 624-25-4885-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA SUHAREKË”, më 11/08/2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “BAJRAM HA.GASHI” B.I. me nr. 2025/0544 , e datës 27/06/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i objektit të NPL EKO - THERANDA ne Shirok”, me numër të prokurimit 624-25-4885-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “KOMUNA SUHAREKË”. **AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.**

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 11.06.2025, “KOMUNA SUHAREKË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i objektit të NPL EKO - THERANDA ne Shirok” me numër të prokurimit 624-25-4885-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 477,130.00 €uro.

Me 19.06.2025, OE “BAJRAM HA.GASHI” B.I., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 20.06.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27/06/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga “BAJRAM HA.GASHI” B.I., me nr. 2025/0544 lidhur me aktivitetin “Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i objektit te NPL EKO - THERANDA ne Shirok” me numër të prokurimit 624-25-4885-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: “BAJRAM HA.GASHI” B.I., Bajrain Ha Gashi B.I me adresë në Suharekë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ptojekt ine bashkfinancim - Ndertimi i objektit te NPL EKO - THERANDA ne Shirok me Numër të prokurimit: 624-25-4885-5-2-1 Numër i brendshëm: 624-25-47-521 Kundër (NJOFTIM PËR KONTRATË TE AK), të datës: 11.06.2025 të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokuritni.rks-goy.net>, ka berë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 19.06.2025 sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,

Refuzohet në tërësi kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik Bajram Ha Gashi B.I për këto arsye:

Pretendimi 1 — i pabazuar - Pas anallizes te pretenduar nga OE-së dhe krahasimit me dokumentacionin e tenderit, Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) dhe Udhëzuesin Nr, 002/2024, Autoriteti Kontraktues konstaton se Inxhinietin e Diplomuar në Inxhinieri Makinerike ose master — drejtimi Termoenergjetik dhe Termoteknike, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit dhe 2 vite pas certifikimit për auditim të energjisë në ndërtesa eshte ne Përputhshmëri me LPP-ne dhe Udhëzuesin e KRPP-së, sipas nenit 51.4 të LPP-së, çdo kriter për përzgjedhje duhet të jetë drejtpërdrejt i Hdhur me objektin e kontratës, i domosdoshëm për realizimin e saj, dhe proporcional ndaj natyrës dhe madhësisë së kontratës. Në përputhje me këtë, Udhëzuesi 002/2024 thekson në mënyrë të qartë se kërkesat teknike dhe profesionale duhet të bazohen në lëndën dhe vlerën e kontratës dhe të kenë qëllim sigurimin e kualitetit të zbatimit, jo kufizimin e konkurrencës.

Justifikimi teknik i kërkesës për të cilën është shpallur ky aktivitet ka për qëllim ndërtimin e objektit të NPL EKO - THERANDA, që përfshin instalime teknike të brendshme (ndër të tjera, sistemet e ventilimit, ngrohjes, ftohjes dhe kursimit të energjisë), ku auditimi i energjisë dhe menaxhimi termik janë elemente kyç. Kërkesa për një Inxhinier të Makinetisë me drejtim Termoenergjetik dhe Termoteknik është bërë për të siguruar ekspertizë të specializuar në efikasitetin energjetik të ndërtesës, i cili është komponent përbërës i projektit. Certifikimi për auditim të energjisë është një element ligjëtisht i mbështetur në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare për ndërtim të qëndrueshëm dhe eficiencë energjetike. Përvoja pas certifikimit për auditim të energjisë, kërkuar për 2 vite, është kërkesë profesionale për të siguruar që personi ka përvojë reale në zbatim praktik të asaj certifikate dhe nuk është vetëm posedues formal i saj.

Kjo Kërkesë e vendosur nga AK duke e kuptuar lenden e aktivitetit nuk paraqet diskriminim, nuk ka asnjë element në dokumentacionin e tenderit që nënkupton se kjo kërkesë është bërë për operatorë të caktuar ose që favorizon një ofertues të vetëm. Për më tepër, kritet nuk e ndalon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që posedojnë staf me përgatitje të njëjtë apo ekuivalente — pasi në bazë të LPP-së dhe praktikës së prokurimit publik, diplomat ekuivalente dhe drejtimet ngjashme akademike të pranura ligjërisht në Kosovë mund të paraqiten si dëshmi valide.

Kërkesa për Inxhinier të diplomuar në Makineti me drejtim Termoenergjetik dhe Termoteknik, me përvojë pune dhe certifikim për auditim të energjisë në ndërtesa, është proporcionale, e justifikuar teknikisht dhe nëpërputhje me LPP-në dhe Udhëzuesin 002/2024.

Prandaj, nuk paraqet kufizim të panevojshëm apo diskriminim, dhe nuk ka arsye për ndryshim të saj.

Pretendimi 2 ~ i pa bazuar - Në lidhje me pretendimin që kërkesa për bazën për prodhim të asfaltit është diskriminuese dhe pa lidhje me lëndën e kontratës, Autoriteti Kontraktues thekson se Projekti përfshin punime me asfalt konkretisht të përcaktuara në pozicione të paramasës, në pozicionin përkatës të paramasës, është e përfshirë qarte "Furnizimi, transporti dhe punimi i asfaltbetonit nga materialet në njëtrajtshëm AB 16 me trashësi $t=8,0$ cm në shiritin e qarkullimit të automjeteve duke përfshirë lyerjen me emulsion $0,50\text{kg/m}^2$." Ky pozicion konfirmon se kontrata përfshin punime të asfaltimit.

Pretendimi nga ana e juaj që "projekti nuk përmban fare asfalt" është faktikisht i pasaktë, sepse vetë pozicionet e paramasës e hedhin poshtë këtë pretendim.

Pretendimi 3 — i pa bazuar - Sipas nenit 26 të LPP-së, autoriteti kontraktues ka të drejtë të kërkojë dëshmi për kapacitete teknike që lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e kontratës. Kjo përfshin: mjetet teknike, objektet e prodhimit, ose furnizimin përmes marrëveshjeve të vlefshme.

Në këte aktivitet prokurimi, AK ka parapare në DT se OE duhet të posedojë: "... në prodhim pllakat Terastone... ose marrëveshje për furnizim."

Pra, nuk është vendosur kërkesë ekskluzive që OE të jetë prodhues, por është lejuar që ai të paraqesë marrëveshje për furnizim me prodhues të certifikuar, në përputhje me standardet e kërkuara. Rregullorja 001/2022 (me ndryshimet e 002/2024) Sipas nenit 20.3, kriteret teknike mund të përfshijnë kërkesa për pajisje ose furnizime të sigurta, nëse janë: të lidhura me objektin e kontratës, proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e saj, dhe të barabarta për të gjithë OE-të. Duke paraparë dy mënyra të barabarta të përmbushjes së kërkesës — ose përmes prodhimit të drejtpërdrejtë ose përmes marrëveshjes për furnizim — AK ka respektuar parimet e barazisë dhe proporcionalitetit. Në DT parashikon në mënyrë të qartë që OE mund të: posedojë linjën e prodhimit, ose të ketë marrëveshje valide për furnizim me prodhues të Hcencuar që plotësojnë standardin EN 13748-2:2004.

Kjo kërkesë është e justifikuar teknikisht, pasi siguron cilësinë e produktit, përputhshmërinë me standardet evropiane dhe garanton kontroll të furnizimit gjatë implementimit të projektit.

Autoriteti Kontraktues konstaton se kërkesa për prodhim ose marrëveshje për furnizim është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor, dhe se nuk ekziston diskriminim apo kufizim i pjesëmarrjes në tender.

Pretendimi 4 — i pa bazuar — sa i përket këtij pretendimi sasia e kërkuar 8 kamion kiper kjo kërkesë është në përputhje me natyrën dhe volumet e projektit. Sasia e 8 kamionëve kiper është vlerësuar, bazuar në

logjikën e përshejtit të përpunimit dhe transportit të vazhdueshëm, për të përmbushur afatin kontraktual dhe për të siguruar: një rrjedhë të pandërprere të punimeve, një kapacitet të mjaftueshëm të furnizimit në kantier gjatë fazave intensive të ndërtimit.

Kjo kërkesë për 8 katnion kimer nuk është as e pazakontë dhe as e papërballueshme për OE- të që janë realisht të aftë të realizojnë kontrata të tilla. Nëse një OE nuk mund të angazhojë as 8 kamionë përmes rrjeteve të veta ose partnerëve, kjo ngre dyshime për kapacitetin e tij operacional, e jo për kufizimin nga AK.

Sasia prej 8 kamionë kiper është proporcionale, e justifikuar teknikisht dhe e arsyeshme për realizimin e projektit. Kjo kërkesë nuk kufizon konkurrencën, sepse nuk kërkon pronësi dhe lejon qasje përmes marrëveshjeve të qirasë. Pretendimi nga ana e juaj nuk ofron fakte bindëse që kërkesa aktuale është diskriminuese apo joligjore.

Pretendim - 5 — 10 i pa bazuar - Bazuar në analizën teknike të Dosjes së Tenderit dhe në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues refuzon pretendimet ankimore të paraqitura nga OE për makineritë e përfshira në Aneksin 7, me këtë arsye: Vinci i kërkuar me lartësi deri 17m dhe kapacitet deri 2000kg është përcaktuar sipas nevojave të qarta teknike të ndërtimeve në lartësi të objektit P+1 dhe për pozicionimin e elementeve ndërtimore; specifikimi i tipit mbi rrota gome' lidhet me kërkesën për fleksibilitet të lëvizjes në terren. Kërkesa është proporcionale dhe e justifikuar sipas nenit 51.4 të LPP.

Gjysmë-rimorkio me kapacitet 60 ton është e nevojshme për transportin e makinerive të rënda si buldozerët, finisherët dhe makineritë për gryerje asfalti. Përdorimi i mjeteve me kapacitet më të ulët do të kërkonte më shumë transport dhe më pak efikasitet. Kërkesa është e drejtë dhe s'kufizon konkurrencën pasi lejohet edhe përmes marrëveshjeve.

Sasia dhe tonazhi i ekskavatorëve është përcaktuar sipas volumit të gërmimeve, të tokës dhe nevojës për paralelizëm në punime. Përdorimi i dy llojeve të ekskavatorëve lejon fleksibilitet teknik. Kërkesa është në përputhje me lëndën e kontratës dhe LPP.

Cilindri ngjeshës min. 25 ton është i domosdoshëm për ngjeshjen e shtresave mbajtëse të rrugëve/platove me kërkesa të larta mbajtëse. Kjo kërkesë teknike është e arsyetuar me pozicionet për mbushje dhe asfaltim. Nuk ka efekt diskriminues pasi lejohet qasje përmes qirasë.

Makineritë për asfalt (cilindër, makinë prerje/gryerje, finisher, kamion për asfalt) janë të justifikuara për pozicionet konkrete në paramasë si: shtrimi i asfaltbetonit AB16, emulsion, etj.

Pa këto pajisje, zbatimi i punimeve do të ishte i pamundur. Kërkesat janë në përputhje me LPP dhe Udhëzuesin 002/2024.

Droni me LIDAR dhe RTK/PPK është kërkuar për kontroll preciz të volumit, terrenit dhe dokumentimit të progresit me teknologji 3D. Kjo ndihmon në transparencë, kontroll të cilësisë dhe auditim të punimeve, në përputhje me standardet moderne të mbikëqyrjes. Kërkesa është proporcionale me objektivat e menaxhimit teknik dhe financiar të kontratës.

Pretendimi 11-12 — i pabazuar — Sa i perket pretendimeve nga ana e juaj sasia është produkt i projektit të detajuar teknik të hartuar nga kompani e licencuar. Sasit e vendosura janë përllogaritur nga projekti i miratuar teknik, i hartuar nga kompani e licencuar profesionale për projektim inxhinierik. Me qfar

konstatimi erdhet ju ne perfundim qe nuk korrespodon me projektin pasi qe nuk keni asnje referenc konkrete teknike. Ne mungesë të referencave konkrete, pretendimet mbeten spekulativ dhe pa baze, dhe bie ndesh me parimin e përgjegjësisë se OE-së për të ofruar çmim mbi bazën e projektit të ofruar nga AK.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “BAJRAM HA.GASHI” B.I., janë parashtruar si në vijim:

Për këtë procedurë të prokurimit pas publikimit te dosjes se tenderit kompaniajonë fillimisht është interesuar për ofertim mirëpo pas analizimit të dosjes së tenderit ka rezultuar se disa kriteret janë joproporcionale per objektin e kontratës dhe të njëjtat favorizojnë operatorë të caktuar apo grupe të ngushta të interesit në kundërshtim me parimin barazisë, konkurrencës dhe qasjes së lirë në treg të garantuara me LPP. . Ne si OE të cilët posedojmë kapacitete teknike dhe profesionale, jemi palë interesi në këtë procedure të prokurimit, andaj brenda afatit të paraparë kemi ushtruar të drejtën tonë ligjore kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim më 19.06.2025, por AK, ka refuzuar kërkesën tonë dhe ka lënë ne fuqi vendimin e saj kundërligjor, - vendimin për mosndryshim të kushteve e kriterve për ofertim

Andaj ne, përmes kësaj ankese paraqesim pretendimet tona, mbështetur në argumente e referenca ligjore.

Pretendimi i parë: Te kërkesa 3 e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të ketë në listën e paktën këtë staf profesional, pika

f) Inxhinier i Diplomuar në Inxhinieri Makinerike ose master – Drejtimi Termocentralit dhe Termoteknikë - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, i njëjti duhet të jetë i certifikuar për “Auditimin e energjisë në ndërtesa” me përvojë pune min. 2 vite pas certifikimit.

Kërkesa 4 - Operatori Ekonomik duhet të ketë Bazën për prodhim të Asfaltit, Bazën për prodhim të Betonit dhe Gurëthyes të licencuar në Pronësi apo marrëveshje për furnizim..

Kërkesa 5 - Operatori Ekonomik duhet të posedojë në prodhim pllakave Terastone me granit natyral (Kuarc, Granit, Bazalt) etj. me ngjyre dhe granulat sipas detalit në projekt. Pllaka terastone me dimensione 60x40x6cm, të kalibruar, të gërryer, të rrezuar dhe impregnuar me tehe chamfer. Në vlera referuese të Standardeve Evropiane EN 13748-2 2004. Pllaka për përdorim në hapësira të hapura në ambiente të jashtme apo marrëveshje për furnizim.

Te disa makineri/mjete sipas Kërkesës 6 - Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës Aneksi 7

Gjithashtu disa sasi të pozicioneve nuk janë në proporcion sipas projektit. Kemi vërejtur se si AK ka bërë shkelje të LPP-së dhe RRPP-së duke vendosur kriteret diskriminuese apo favorizuese për operatorë të caktuar ekonomik, duke mos qenë relevante me natyrën e punës dhe objektin e kontratës e gjithashtu duke kufizuar konkurrencën të cilat rrjedhimisht qonë edhe në dëmtimin e buxhetit.

Me nenin 51.3 të LPP-së përcaktohet: " Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse".

Është gjithashtu kriteret e kontestuara për shkak të kërkesës për ri shqyrtim nuk janë as relevante dhe as proporcionale me natyrën e aktivitetit të prokurimit.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Te Kërkesa 3 - Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën te paktën këtë staf professional, pika

f) Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master – Drejtimi Termoenergjetik dhe Termoteknike - me përvojë punc min. 5 vite pas diplomimit, i njejt i duhet te jetë i certifikuar per “Auditimin e energjisë ne ndërtesa” me pervoj pune min. 2 vite pas certifikimit.

Kjo kërkesë është shumë specifike dhe kufizuese dhe si e tillë është plotësisht diskriminuese sepse duke e analizuar natyrën e kontratës dhe punët të cilat do te rcalizohen një kërkesë e tillë është absolutisht e pa nevojshme. Specifike dhe në dukje të destinuar për operator të caktuar ekonomik e bën fakti i drejtimit specifik dhe vitet e përvojës së punës pas certifikimit. Nuk mund te aplikohen kërkesa të shumëfishta brenda të njëjtës kërkesë, kualifikimi profesional, certifikimi përkates, përvoja e punës e dy tre fisht, fillimisht 5 vite pas diplomimit dhe 2 vite pas certifikimit, e bëjnë këtë kriter dukshëm diskriminues për konkurrencën e gjërë e të lirë nga njëra anë dhe gjithsesi është favorizues për dikë nga ana tjetër. Hartuesi i një kërkesë të lillë do duhej të përballej ligjërisht me pasoja për vcprimc të tilla kundërligjore

Kërkesa, në mënyrë që të jetë e përshtatshme sipas kriterëve të përcakluara me LPP neni 51, pika 3 dhe 4 duhet gjithsesi të ndryshohet, andaj kemi kërkuar që kërkesa sipas DT për “Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master – Drejtimi Termoenergjetik dhe Termoteknike me pervojë 5 vite dhe te jetë certifikuar per “Auditimin e energjisë ne ndërtesa” me pervoj pune min. 2 vite pas certifikimit” të ndryshohet dhe atë që drejtimi “Termocnergjetik dhe Termoteknike” te largohet sepse nuk ka te bëjë me natyrën e kontratës dhe punët të cilat do të rcalizohen dhe në vend të këtij drejtimi rntind të zëvendësohet me “Termoenergjetik”, sc tani në kuader te fakultetit nuk ekziston një program i tillë, gjithashtu përvoja e punes min. 2 vite pas certifikimit të largohet në tërësi si kriter.

Pretendimi ankimor 2

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 4 - Opratori Ekonomik duhet te ketë Bazën per prodhim te Asfaltit, Bazën për prodhim te Betonit dhe Gurëthyes te licencuar ne Pronësi apo marrëveshje për furnizim..

Kjo kërkesë është plotësisht diskriminuese sepse të kërkohej posedimi (apo marrëveshja) për Bazën për prodhim te Asfaltit, e në kuader të projektit nuk ka fare asfalt të realizohet, shihet haptas se kjo është kudrisje për operator të caktuar.

Duke u nisur nga këto fakte, kemi vlerësuar se kërkesa për Bazën për prodhim te Asfaltit është jo proporcionale dhe jorelevante për kontratë dhe si e tillë duhet të largohet nga dosja e tenderit.

Bazuar ne paramasen e kësaj procedure të prokurimit dhe parallogari kemi konstatuar se në asnjërin nga pozicionet nuk ka punë të cilat përfshijnë asfaltimin.

Pretendimi ankimor 3

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 5 - Operatori Ekonomik duhet te posedoje ne prodhim pllakave Terastone me granil natyral (Kuarc, Granit, Bazalt) etj. me ngjyre dhe granulat sipas detalit ne projekt. Pllaka terastone me

dimenzion 60x40x6cm, e kalibruar, e gerryer, e rrezuar dhe impregnur me tehe chamfer. Në vlera referuese të Standardeve Evropiane EN 13748-2 2004. Pllaka për përdorim në hapësira të hapura në ambiente të jashtme apo marrëveshje për furnizim.

Kjo kërkesë është jo-proporcionale e jo relevante dhe si e tillë e pajustificueshme për realizimin e projektit, e dekurajon konkurrencën dhe duket se është e destinuar për të favorizuar operatorë të caktuar ekonomik, plotësisht në kundërshtim me parimet e garantuara nga LPP. Andaj, kjo kërkesë, siç është prezantuar në njoftimin për kontratë, është plotësisht diskriminuese sepse të kërkohej që OE të posedojë një lloj tejet specifik të pllakave siç janë të përshkruara në kërkesë ndërsa të njëjtat nuk janë të paraparë në projekt dhe në paramasë me paralogari. Shihet haptas se kjo është kudrisje për operator të caktuar, dhe duke pasqyruar parasysh që është kërkesë tejet specifike, është në kundërshtim me LPP, i cili i dekurajon specifikimet e tilla siç janë prezantuar në njoftimin për kontratë në këtë procedurë prokurimi, pikërisht sepse janë diskriminuese.

Një qasje e tillë duhet të ndërpritet në këtë fazë, andaj kërkojmë që kërkesa 5 të largohet tërësisht nga dosja e tenderit.

Pretendimi ankimor 4: ANEKSI7 LISTA E PAISJEVE Aneksi 7 - Lista e Makineris FTD)Nr.Lloji i mekanizimit dhe pajisjeveasia e kërkuar:

Bazuar në natyrën e aktivitetit të prokurimit, bazuar në paramasën dhe paralogarinë e ngarkuar nga AK - Komuna Suharekë, të gjitha keto pajisje teknike, të cilat nuk kanë kontribujtë aspak në aspektin operativ e funksional me objektin e kontratës, janë publikuar vetëm për të kufizuar konkurrencën dhe kështu AK t'i hapë rrugë vetes për të lidhur kontratë me kompani të caktuar,.

Te Aneksi 7. - LISTA E PAISJEVE -makineria me nr rendor 1. Kamion Kiper për transport të materialit mbi 10 ton pesha e lejuar sasia 8 copë, duke pasqyruar në konsiderat punët të cilat do të realizohen nuk ka nevojë për këto kamionave, si rrjedhojë maksimumi i sasive që nevojitet është 4 pajisje të tilla. Pasi që një sasi e tillë e kërkuar nga AK, prej 8 kamionësh është joproporcionale dhe si e tillë dekurajon konkurrencën e lirë dhe qasjen e barazisë në treg duke favorizuar operatorë të caktuar ekonomik.

Pretendimi ankimor 5 : Te Aneksi 7. - LISTA E PAISJEVE -makineria me nr rendor 2. Vinc ndërtimi mbi rrota gome, pesha bartëse deri 2000kg, lartësia deri 17m

Pra nga vetë kërkesa specifike duke e përcaktuar një makineri me karakteristika kaq specifike, duket qartë se ju keni favorizuar operator ekonomik të caktuar dhe si e tillë të jete përcaktuese për dhënien e kontratës është kriter diskriminues dhe favorizues.

Kërkesa për "Vinc ndërtimi mbi rrota gome, pesha bartëse deri 2000kg, lartësia deri 17m duhet të largohet si kriter me këto kërkesa specifike. Duke pasqyruar parasysh lartësinë e objektit ku do të punohet. vinçi mundet pa problem ta zëvendësojë me këto karakteristika: me vinç me lartësi minimumi 12m me peshë bartëse minimum 1000kg, në këtë mënyrë plotësohen kushtet sipas LPP-së për të vendosur si kriter përzgjedhës. Për më tepër, çfarë rendësi ka a është vinçi me rrota apo montohet aty, përderisa funksioni i vinçit është bartja e ngarkesave, specifikimet e tilla janë tërësisht jorelevante dhe jo proporcionale PO ashtu pesha bartëse duhet të përcaktohet pesha minimalejo ajo maksimale sepse është jorelevante, përderisa ka specifikime si gjatësia e krahut e cila po ashtu duhet të specifikohet si minimale dhe jo maksimale siç e keni definuar ju. Në pretendim që një kërkesë e tillë është diskriminuese dhe e rezervuar (destinuar) për operator të caktuar duke krijuar favorizime, andaj duhet të ndryshohet sipas

propozimit nga ne në mënyrë që të jetë në funksion të konkurrencës së lirë dhe krijimit të mundësive për qasje të barabartë në treg të më shumë operatorëve ekonomik. Kjo është në favor edhe të menaxhimit të mirë të parasë publike, pjesë për të cilën AK do duhej të kujdesej më shumë sesa kujdesi i dritanishëm.

Pretendimi ankimor 6: Te Aneksi 7. - LISTA E PAISJEVE -makineria me nr rendor 3.Gjysëmrimorkio me pesh min 60 ton vërcjmë se kërkesa për një makineri me karakteristika kaq specifike krijon përshtypjen e favorizimit të një operatori ekonomik të caktuar. Kjo kërkesë jo vetëm që kufizon konkurrencën, por gjithashtu përbën kriter të mundshëm diskriminues dhe favorizues në dhënien e kontratës.

Kemi kërkuar rishqyrtimin e këtij specifikimi dhe të largohet kërkesa ekzistuese për gjysëmrimorkion me peshë minimale 60 tonë. Në vend të saj, propozojmë që kërkesa të riformulohet në "Gjysëmrimorkio me peshë minimale 10 tonë", duke pasur parasysh që makineritë përkatëse mund të transportohen në forma të ndryshme dhe që nuk ka pagjisje në listë që e tejkalojnë peshën prej 60 tonësh.

Pretendimi ankimor 7: Te Aneksi 7. - LISTA E PAISJEVE -makineria me nr rendor 7. Ekskavator për gërmim 20- 25 Ton; sasia 2 copë dhe Ekskavator për gërmim 25-30 Ton sasia 3 copë; pra nga vetë kërkesa specifike duke e përcaktuar një makineri me karakteristika kaq decitive dhe numrin e tyre, vrehet qartë se ju keni favorizuar operator ekonomik të caktuar dhe si e tillë të jetë përcaktuese për dhënie të kontratës është kriter diskriminues dhe favorizues.

Ne pretendojmë se këto kritere me këto specifikime duhet të rishqyrtohen dhe të largohet kërkesa ekzistuese për këto dy pika sepse janë komplet të pa nevojshme për objektin e kontratës.

Pretendimi ankimor 8: Te Aneksi 7. - LISTA F. PAISJEVE -makineria me nr rendor 7 Ngjeshës Cilindër minimum 25 Tonë

Kjo kërkesë për këtë pasisje nuk është relevante me objektin e kontratës, pasi që është e pa nevojshme e gjithashtu diskriminuese që të ketë një kufizim minimum 25Ton, duke e analizuar projektin dhe punët të cilat do të kryhen të përshkruara në parametere në asnjë pozicion nuk ka nevojë që të punohet me këtë lloj makinerie.Prandaj po besojmë se edhe kjo kërkesë është plotësisht diskriminuese dhe njëherit favorizuese për operator të caktuar.

Pretendojmë se kjo kërkesë Ngjeshës Cilindër minimum 25 të largohet nga dosja e tenderit, pasi që siç u tha më sipër tonazha kaq e madhe është plotësisht e panevojshme për këtë kontratë dhe në vend të minimum 25 ton të kërkohej minimum 4 ton, pasi që e kemi një kërkesë për cilindër 12-20 ton.

Pretendimi ankimor 9: Te Aneksi 7. - LISTA E PAISJEVE, -makinerit me numra rendor:

12.Ngjeshese (Cilinder) Asfalti 7-8 Ton;

13.Ngjeshese (Cilindër) Asfalti min 12 Ton;

14.Makinë për prerjen e asfaltit-betonit;

15.Makineri për prerjen-gryerjen e Asfaltit min 26 ton

16.Kamion kiper për transport të asfaltit të gatshëm min. 20 ton

17.Finisher për shtrirjen e Asfaltit

Pra, duket haptas se AK ka tentuar favorizimin e OE të caktuar, sepse të gjitha këto makineri me specifika të tilla dhe për më tepër fare nuk kanë të bëjnë me natyrën e kontratës, nuk janë relevante me objektin e kontratës, dhe si e tillë të jetë përcaktues për dhënie të kontratës është kriter diskriminues dhe favorizues. Andaj kërkojmë që këto kritere të largohen nga dosja e tenderit.

Pretendimi ankimor 10: Te Aneksi 7. - LISTA E PAISJEVE -pajsa me nr rendor 20- Dron i pajisur me sensor LIDAR dhe me mundësi operimi RTK dhe PPK. Droni të jetë i regjistruar në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Ne vlerësojmë se:

- Kërkesa për LIDAR dhe RTK/PPK nuk është e justifikuar për qëllimin e kësaj kontrate (përcjellje e ndërtimit të një objekti të vogël P+1), dhe përbën kërkesë të panevojshme që rrit koston dhe kufizon konkurrencën.

Këto kritere bien ndesh me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës, që garanton konkurrencë të drejtë dhe mosdiskriminim.

Kërkojmë edhe ky pretendim yni të vlerësohet me kujdes e të rishikohet bëhen përmirësimet përkatëse në dosjen e tenderit, duke siguruar konkurrencë të hapur dhe barazi për të gjithë operatorët dhe mund të kërkojë një dron me specifika me të thjeshta, i cili mund të kryjë funksionin e njëjtë pa asnjë problem.

Pretendimi ankimor 11

Është e nevojshme që të sqarohet një pozicion i lillë, andaj kemi kërkuar nga AK ta sqarojë sasinë e këtij posicioni sepse nuk korrespondon me projektin.

5. PUNËT E ARMATURËS Përshkrimi i pozicionit Njësi

Pretendimi ankimor 12

Është e nevojshme që të sqarohet një pozicion i tillë, andaj kemi kërkuar nga AK Kërkojmë nga AK ta sqarojë sasinë e këtij posicioni sepse nuk korrespondon me projektin..

7. PUNËT E MURATIMIT:

Këto kërkesa, të përfshira në dosjen e këtij tenderi, janë në mënyrë të qartë diskriminuese dhe në favor absolut të një operatori të caktuar ekonomik. Kërkesa të tilla kufizuese dhe favorizuese zvogëlojnë ndjeshëm konkurrencën, duke rënë ndesh me Ligjin për Prokurimin Publik, si dhe me Rregulloren për Prokurimin Publik. Për më tepër, këto specifikime nuk janë as relevante dhe nuk lidhen aspak me natyrën e punëve që pritet të realizohen në kuadër të kësaj kontrate.

>Neni 1 Qëllimi 1: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë

të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. 2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. 3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellin duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaf duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

>Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti: 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. 2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

> Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi: 1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik. 3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohej që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajc ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik. 4.

Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik. 5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit. 6. Gjatë udhëheqjes së aktivitetit të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe krite të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar

kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

> Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit 4.3 l'ë gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim: a. Konkurrenca - në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive. b. Efikasiteti & Efektiviteti - duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për parandë për Autoritetin Kontraktues. c. Drejtësia/Mos- diskriminimi - Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmangët çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial. d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet - Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhuratat, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit. e. Transparenca - Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente. f. Llogaridhënie - Të kctë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme. g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikën më të mirë..

> Neni 17 Dosja e Tenderit: 17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Ligji nr 04/L-042, i amendamentuar. Neni 1 i LPP-së-Qëllimi, Neni 6 i LPP-së-Ekonomiciteti dhe efikasiteti, Neni 7 i LPP-së- Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, Neni 28 Specifikimet teknike, Neni 51 Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes, Neni 52- Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës, Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, Rregullore NR.002/2024 Plotësim ndryshimi i Rregullores nr.001/20022 për prokurimin publik, Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit, Neni 17 Dosja e Tenderit, Neni 97 Shkeljet e rënda. Si përfundim në si OE, bazuar në prova dhe dëshmi, përkatësisht faktet e prezantuara si më sipër, kërkojmë që OSHP, të autorizojë ekspert shqyrtues profesional dhe të pa anshëm i cili i trajton të gjitha pretendimet ankimore sipas nenit 113 të LPP-së dhe paneli shqyrtues të nxjerrë këtë: VENDIM të Aprobohet në tërësi e bazuar ankesa e OE Bajram I la Gashi BI dhe të Anullohet, njoftimi për kontratë, Urdhërohet AK, që të nxjerrë njoftim mbi korrigjimin e gabimit dhe aplikohen dispozitat e nenit 53.7 të LPP-së, bëhet korrigjimi i dosjes së tenderit, Lejohet, kthimi i mjeteve të deponuara në emër të ankesës. Inicohet, procedurë sipas nenit 25.8, të LPP-së ndaj zyrtarit përgjegjës për kurdisje të procedurës. Autoriteti kontraktues - komuna Suhareke, pavaresisht kërkesës për ri shqyrtim nuk ka aplikuar dispozitat e nenit 53.7, të LPP-së dhe nuk e ka zgjat afatin për ofertim si rrjedhojë në si kompani për këtë procedurë të prokurimit disponojmë me prova dhe dëshmi me të cilat konfirmohet mashtrimi dhe keqpërdorimi në prokurim publik dhe në rast mos zbatimit të dispozitave ligjore dhe shmangies së përgjegjësisë për përmisimin e dosjes së tenderit në si kompani do të ndermarrim veprimet ligjore.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 30.06.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0544/25, ndërsa me datë 07.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0544 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të

vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK pajtohet me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “BAJRAM HA.GASHI” B.I., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0544 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim Hyrës

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Suharekës, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur, vlerë e mesme, lloji i kontratës punë, vlera e parashikuar është: 477,130.00 Euro

AK me dt. 11.06.2025 ka publikuar Njoftimin për kontratë ndërsa hapja e ofertave është planifikuar të bëhet me dt. 27.06.2025 vlenë të ceket fakti se AK ka shkurtuar afatin me arsyetimin se projekti është bashkëfinancim me DEMOS ku mjetet financiare janë të dedikuara të shpenzohen gjatë vitit fiskal në të kundërtën mund të rezutojë me humbjen e grantit. Poashtu AK sqaron se DEMOS si donator ka vendosur kushte për përfundimin e projektit brenda një periudhe të caktuar, duke e bërë të domosdoshëm shkurtimin e afateve për të respektuar marrëveshjet dhe kushtet e bashkëfinancimit. Duke marrë parasysh urgjencën për shfrytëzimin e mjeteve të grantit brenda këtij viti kalendarik, kohën e nevojshme për vlerësim dhe trajtimin e ankesave, si dhe bazën ligjore të parashikuar në nenin 46 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues justifikon shkurtimin e afatit të dorëzimit të tenderëve me qëllim të realizimit të suksesshëm të këtij aktiviteti të prokurimit.

Kundër njoftimit për kontratë AK ka pranuar kërkesën për ri-shqyrtim, ndaj kriterëve të aplikuar nga AK në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë. AK, ka nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim si të pabazuar, duke arsyetuar secilin pretendim ankues, me ç'rast OE ankues, nuk është pajtuar dhe brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP me pretendime ankimore të njëjta si në kërkesën për ri-shqyrtim.

Përgjigje në Pretendimet e OE ANKUES

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se pikënisja e problemit ka të bëjë me atë se për aktivitetin e prokurimit në fjalë, OE ankues pretendon se AK-ja ka aplikuar kriterë diskriminues dhe favorisues, kurse AK ka sqaruar se ka shkurtuar afatin për dorëzimin e ofertave me arsyetimin se projekti është bashkëfinancim me DEMOS ku mjetet financiare janë të dedikuara të shpenzohen gjatë vitit fiskal në të kundërtën mund të rezutojë me humbjen e grantit. Eksperti shqyrtues

sqaron se bazuar në platformen elektronike e-prokurimi, nuk kemi hasur në ndonjë rekomandim të lëshuar nga KRPP-ja për këtë aktivitet prokurimi, përmes të cilit mund të vërtetohej fakti se AK ka përdorë kritere diskriminuese siç pretendon tani OE ankues.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike E-prokurimi, AK në dosje të tenderit tek kërkesat e kapacitetit Teknik dhe profesional ka aplikuar kërkesën si në vijim;

Kërkesa 3 - Operatori Ekonomik duhet të ketë në listën të paktën këtë staf profesional

f) Inxhinier i Diplomuar në Inxhinieri Makinerike ose master – Drejtimi Termoenergjetik dhe Termoteknike - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, i njëjti duhet të jetë i certifikuar për “Auditimin e energjisë në ndërtesa” me përvojë pune min. 2 vite pas certifikimit.

Dëshmia 3 -

- Diplomati përkatës – Kopje, Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës;
- Kopje e kontratës ose parakontrate e punës me punëdhënësin mbi angazhim për këtë projekt;
- CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga punëdhënësit;
- Një deklaratë me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vëltur nga Operatori Ekonomik për pikën a) & c)
- Certifikatat apo diplomat për stafin profesional.

Siç vërehet nga kërkesa e dosjes së tenderit, është kërkuar që operatori ekonomik duhet të posedojë disa inxhinierë në mesin e tyre edhe një Inxhinier i Diplomuar në Inxhinieri Makinerike ose master – Drejtimi Termoenergjetik dhe Termoteknike - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, i njëjti duhet të jetë i certifikuar për “Auditimin e energjisë në ndërtesa” me përvojë pune min. 2 vite pas certifikimit.

AK në arsyetimin e dhënë lidhur me refuzimin e pretendimit ankimor 1 si të pa bazuar, ka arsyetuar se një kërkesë e tillë është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e prokurimit, i domosdoshëm për realizimin e saj. Poashtu AK arsyeton se qëllimi i aktivitetit të prokurimit është ndërtimi i objektit të NPL-EKO THERANDA, andaj në aspektin Teknik, një kërkesë e tillë është bërë për të siguruar ekspertizë të specializuar në efikasitetin energjetik të ndërtesës sepse aty përfshihen; Instalime teknike të brendshme (ndër tjera, sistemet e ventilimit, ngrohjes, ftohjes dhe kursimit të energjisë).

Më tej eksperti sqaron se, në platformen elektronike e-prokurimi nuk kishte ndonjë rekomandim nga KRPP-ja lidhur me këtë aktivitet prokurimi sa i përket kritereve të aplikuar nga AK, kurse sa i përket dëshmisë së kërkuar, AK-ja ka lejuar që OE përveç stafit me kontratë mund ta angazhojë edhe staf me parakontratë, e në rastin konkret një inxhinier me profil si në kërkesën e dosjes së tenderit. Në këtë kontekst ne do të vazhdojmë të shqyrtojmë si të vetmin arsyetim valid atë që është ofruar nga Autoriteti Kontraktues, lidhur me pretendimin ankimor 1 se kërkesa që Inxhinieri i Diplomuar në Inxhinieri Makinerike ose master – Drejtimi Termoenergjetik dhe Termoteknike - me përvojë pune min. 5 vite pas

diplomimit, i njejt duhet te jetë i certifikuar per “Auditimin e energjisë ne ndërtesa” me pervoj pune min. 2 vite pas certifikimit, është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e prokurimit, e domosdoshëm për realizimin e projektit duke siguruar ekspertizë te sepcilaizuar në efikasitetin energjetik te ndërtesës sepse aty përfshihen; Instalime teknike te brendshme (ndër tjera, sistemet e ventilimit, ngrohjes, ftohjes dhe kursimit të energjisë). Andaj në përputhje me konstatimet e më sipërme vlerësojmë se pretendimi i parë i palës në ankesë është i paqëndrueshëm.

Në pretendimin e dytë ankimor, OE ankues, pretendon se edhe kërkesa me numer katër e vendosur nga AK në dosje të tenderit është tërësisht diskriminuese, sepse kërkohet posedimi apo (marrëveshja) për bazën prodhimin e asfaltit kurse në kuadër të projektit nuk ka fare asfalt. Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se projekti në fjalë është bashkfinancim në mes të Komunes dhe DEMOS, tek file i emertuar “PARAMASA – pa çmime Eko- Theranda për prokurim” e ngarkuar ne e-prokurim nga AK, vërehet se paramasa është ndarë në dy pjesë dhe atë; Pjesa e DEMOS- PA TVSH dhe Pjesa e Komunes-me TVSH. Tek pjesa e komunes është paraparë pozicioni për punët e betoni dhe asfaltit shih pozicionin e paraparë në dokumnetet tenderit tek pjesa e komunes.

Punët e Betonit dhe Asfaltit

PËRSHKRIMI I PUNËVE

Furnizimi, transporti dhe punimi i asfaltbetonit nga materiali i njëtrajtshëm AB 16 me trashësi $t=8,0\text{cm}$ në shiritin e qarkullimit të automjeteve duke përfshirë lyerjen me emulsion $0,50\text{kg/m}^2$. Nësia matëse m^2 sasia 1115,00. AK, në vendimin për refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim e ka arsyetuar se kërkesa është në përputhje me natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe se arsyetimi i dhënë nga OE ankes se në kuadër të këtij projekti nuk ka fare asfalt nuk qëndron për faktin se AK tek paramasa pjesa e komunës ka paraparë pozicionin përmes të cilit do të punohet me asfalt.

Kurse sa i përket pretendimit të tretë lidhur me Kërkesën 5 - Operatori Ekonomik duhet te posedoje ne prodhim pllakave Terastone me granil natyral (Kuarc, Granit, Bazalt) etj. me ngjyre dhe granulat sipas detalit ne projekt. Pllaka terastone me dimensione $60 \times 40 \times 6\text{cm}$, e kalibruar, e gerryer, e rerezuar dhe impregnaur me tehe chamfer. Ne vlera referuese te Standardeve Evropiane EN 13748-2 2004. Pllaka per perdorim ne hapsira te hapura ne ambiente te jashtme apo marrëveshje për furnizim. Sqarojm se AK, në arsyetimin e refuzimit të kërkesës për ri-shqyrtim ka potencuar faktin se kërkesa nuk ka të bëjë me atë se OE duhet të jetë ekskluzivisht prodhues, por është kërkuar që materialet të furnizohen nga prodhues të certifikuar dhe me standartet e kërkuara. Andaj sqarojm se në rastin konkret, AK ka lejuar që nëse OE nuk është vet prodhues, të paraqet marrëveshje me prodhuesit të cilët duhet të jenë te certifikuar sipas dëshmisë kërkuar në dosje të tenderit. Shih Dëshmia 5 - Prodhuesi te jete i certifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per system hermetik te makinerise prodhuese. Produkti te plotesoj standardet ne vazhdim EC (Declaration of Conformity) Produkti te posedoj shenjen CE ne perputhje me direktivat per CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2. Furnizimi i pllakave terase Terastone me granil natyral (Kuarc, Granit, Bazalt) etj. me ngjyre dhe granulat sipas detalit ne projekt. Pllaka terastone me dimensione $60 \times 40 \times 6\text{cm}$, e kalibruar, e gerryer, e rerezuar dhe impregnaur me tehe chamfer. Ne vlera referuese te Standardeve Evropiane EN 13748-2 2004. Pllaka per perdorim ne hapsira te hapura ne ambiente te jashtme. Montimi i materialit duhet ti permbahet udhezimeve teknike per kete lloj materiali dhe gjithmone sipas udhezimeve te Projektantit, prodhuesit si dhe organit mbikqyres per dizajn dhe ngjyre. Produkti karakterizohet me keto pika te veqanta Per pllaka per perdorim ne hapsira te hapura apo ambiente te jashtme. Pastrimi i sipërfaqeve me frekuentim të lartë,

Rezistenca ndaj ngricave dhe kripës me standard te ngjashem te EU. Absorbimi i ujit nga kapilarët, Rezistenca ndaj rrëshqitjes (USRV) ,Rezistencë e shkallës ndaj gërryrjeve, Ekspozimi ndaj makinës fshirëse, Rezistenca ndaj detergjentëve, Shkalla e vështirësisë së largimit të gomave përtypëse, Rezistenca ndaj nxehtësisë së shpuzës së cigares, Qëndrueshmëri ndaj ujit me klor, Efekt i vërtetuar i Easy-to-Clean (për pastrime të lehta nga ngjyra, balta, gjerat ushqimore, reshjet natyrore, gomave përtypëse, vajrat e ndryshem dhe duhet të largohen me lehtësi duke mos lënë mbetje tjera.) te gjitha njollat rezistuese duhet te largohen me uje dhe fshese vetem me nje trajtim. Vërejtje Te gjitha pikat e shenuara me larte te deshmohen me ateste te veqanta te standardeve DIN ose te EU-se. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres. Vërejtje Materiali duhet të posedoj ateste të çertifikuara me shenjën CE. Bazuar në këtë ne do të vazhdojmë ta shqyrtojmë si të vetmin arsyetim valid atë që është ofruar nga Autoriteti Kontraktues, në dosje të tenderit dhe në arsyetimin e dhënë në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar përpretendimin ankimor 3. Andaj në përputhje me konstatimet e më sipërme vlerësojmë se pretendimet dy dhe tre të palës në ankesë janë të paqëndrueshëm.

Dilema tjetër e ngritur nga OE ankues është se edhe kërkesat e aplikuara tek kapaciteti teknik dhe profesional apo 9&1 dhe 9&2 tek dosja e tenderit dhe njoftimit për kontratë, sa i përket aneksit 7 apo Lista e Pajisjeve të kërkuara dhe nuk janë të njevoshme për aktivitetin e prokurimi me theks të veçantë, pajisjet e kërkuara në pozicionet me numer rendor 1,2,3,7,8,9,10,8,12,13,14,17,18,19 dhe 20 të cilat i ka ndare në pretendime ankmiore.

Lidhur me këtë pretendim, pas analizimit të dokumenteve të tenderit dhe shqyrtimit të arsyetimeve të paraqitura në ankesë, eksperti shqyrtues sqaron me sa vijon: Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 27 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i cili përcakton qartë se autoriteti është përgjegjës për hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të tenderit, duke përfshirë edhe specifikimet teknike dhe paramasën. Brenda këtyre kompetencave, autoriteti ka të drejtë të përcaktojë edhe pajisjet e nevojshme dhe më të përshtatshme për realizimin e kontratës, në varësi të natyrës së punës dhe mënyrës së menaxhimit të tij në praktikë.

Po ashtu, bëhet e ditur se operatori ekonomik ankues nuk ka ofruar asnjë fakt konkret, argument bindës apo ndonjë analizë të mirëfilltë teknike që do të mbështeste pretendimin e tij ankimor. Në vend të kësaj, ai ka paraqitur disa shembuj të pajisjeve që mund të aplikohen duke pretenduar minimume të cilat janë në kuadër të kërkesës së AK si shembull në ekspetizë po e paraqesim një, AK ka kërkuar një Vinc ndërtimi mbi rrota gome, pesha bartëse deri 2000kg, lartësia deri 17m OE ankues kërkon që të ndryshohet të behet si vijon; Vinc ndërtimi mbi rrota gome, pesha bartëse min 1000kg, lartësia min 12m. Nëse e analizojmë kërkesën e AK të vendosur në dosje të tenderit e njëjta e përmbush, kërkesën e OE ankues pasi që pesha bartëse është kërkuar deri në 2000kg, lartësia deri 17m pra OE mund të ofertoj me një vinç prej 1000kg dhe lartësi minimale prej 12 pasi që të dyja këto janë në kuadër të kërkesës së AK-se e cila ka vendosur vetëm maksimumin jo edhe minimum të cilat janë lënë të hapura. Andaj arsyet e dhena nga OE ankues nuk mund të konsiderohen si provë e mjaftueshme apo bazë ligjore për të vërtetuar vlefshmërinë e pretendimeve të tij. Çdo aktivitet i prokurimit duhet të trajtohet individualisht, në bazë të veçorive të tij konkrete, si dhe të nevojave specifike të institucionit përfitues, dhe praktikata e ndjekura nga autoritetet e tjera nuk përbëjnë standard detyrues apo referencë juridike që do të impononte ndryshimin e qasjes së Autoritetit Kontraktues në këtë rast.

Eksperti vlerëson se pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues sa i përket pajisjeve të kërkuara tek aneksi 7 janë të pabazuar, pasi Autoriteti Kontraktues në përputhje me nenin 31, paragrafi 1 i LPP-se,

mund të vendosin kërkesa të veçanta në lidhje me mënyrën se si kontrata duhet të ekzekutohet, me kusht që kërkesat mos të shkelin parimet e Nenit 7 të LPP-se dhe që janë paraqitur në dosjen e tenderit. Kërkesat e tilla në lidhje me ekzekutimin e një kontratë kanë qëllim të sigurojnë një nivel të caktuar të kushteve të punës ose të mbrojtjes së mjedisit. Poashtu, eksperti shqyrtues, sqaron se, konform nenit 17 paragrafi 15 të rregullores për prokurim publik nr 002/2024 mbetet në përgjegjësi dhe diskercion të Autoritetit kontraktues, respektivisht ZPP-së përgatitja e kriterëve të përzgjedhjes në atë mënyrë që lejojnë trajtim të barabartë më mes të operatorëve ekonomik, konkurrencë sa më të gjerë dhe të arrihet qëllimi i LPP-se dhe vlera për parën. Në rastin konkret AK e ka arsyetur se përcaktimi i pajisjeve të paraqitura në ankesën 7 nuk përbëjnë diskriminim apo favorizim, por më së miri i përshtatet natyrës së aktivitetit të prokurimit. Si rrjedhojë, pajisjet e kërkuara apo përcaktuar në dokumentet e tenderit, sipas AK-se duhet të mbetet ashtu siç janë publikuar fillimisht. Në këtë kontekst, dhe në mungesë të paraqitjes së fakteve konkret, argumenteve bindës apo ndonjë analize të mirëfilltë teknike që do të mbështeste pretendimin e tij ankimor, ne do të vazhdojmë ta shqyrtojmë si të vetmin arsyetim valid atë që është ofruar nga Autoriteti Kontraktues. Prandaj, në bazë të konstatimeve të mësipërme vlerësojmë se pretendimet e palës në ankesë janë të të paqëndrueshme.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkëlqjeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë dhe ja fal besimin Raportit të tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin për Kontratë të aktivitetit të prokurimit të

Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA SUHAREKË” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i objektit te NPL EKO - THERANDA ne Shirok” me nr. të prokurimit 624-25-4885-5-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - BAJRAM HA.GASHI B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: